

# LIGJ PËR TATIMET MBI PRONËN

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
Закон за  
даноците на имот

**Teksti në  
gjuhën Angleze**  
Law on Property  
Taxes

## PJESA E PARË

### 1. Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

Me këtë ligj rregullohet mënyra e tatimit të llojeve vijuese të pronës:

1. Tatimi mbi pronën;
2. Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën; dhe
3. Tatimi mbi qarkullimin e patundshmërive.

### 2. Definicione

#### Neni 2

Nocione të veçanta të përdorura në këtë ligj kanë domethënien vijuese:

1. **Pronë e patundshme** është toka (bujqësore, ndërtimore, pyjore dhe për kullota) dhe ndërtesat ndërtesa - banimi ose banesat, ndërtesat afariste dhe lokalet afariste, ndërtesat administrative ose lokalet administrative, ndërtesat dhe banesat për pushim dhe rekreim dhe objektet tjera afariste, si dhe instalimet e ndërtuara mbi to ose nën to dhe përherë të ngjitura me to.
2. **Pronar i pronës së patundshme** është personi i cili ka të drejtë që patundshmërinë e vet ta shfrytëzojë dhe me të të disponojë sipas dëshirës së vet.
3. **Pronësi** është e drejtë në pronësi të më tepër personave për pronë të patundshme të pandarë për të cilën pjesa e çdonjërit prej tyre është përcaktuar proporcionalisht sipas tërësisë (pjesa ideale, pronësore).
4. **Shfrytëzues** është personi i cili shfrytëzon pronë të patundshme, pronari i së cilës është i panjohur ose nuk është i afërt ose shfrytëzon pronë të patundshme në pronësi të shtetit ose të komunës.
5. **Frutshfrytëzues** është personi i cili të drejtën për frutshfytëzim e ka fituar në bazë të së drejtës për vepër juridike (marrëveshje, testament) dhe me përkujdesje.
6. **Person** është personi fizik, shoqëria tregtare, personi tjetër juridik si dhe shoqatat e tyre.

7. **Vlerë e tregut të pronës së patundshme** është vlera e pronës e cila mund të arrihet në qarkullimin e lirë në momentin e krijimit të detyrimit tatimor.

8. **Regjistër i pronës së patundshme** është baza e të dhënave të cilin e mban komuna, komunat në qytetin e Shkupi dhe qyteti i Shkupit në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative i cili përmban emrat dhe adresat e të detyruarve tatimorë, sipërfaqen e përgjithshme të tokës dhe të ndërtesave, vlerën e pronës, shkallët tatimore, vendimet për tatimin e paguar.

9. **Regjistër i pronës së tundshme** është baza e të dhënave të cilin e mban komuna, komunat në qytetin e Shkupi dhe qyteti i Shkupit në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, i cili përmban emrat dhe adresat e të detyruarve tatimorë, vlerën e përgjithshme të pronës, shkallët tatimore, vendimet për tatimin e paguar.

## **PJESA E DYTË**

### **TATIMET MBI PRONËN**

#### **1.TATIMI MBI PRONËN**

##### **Lënda e tatimit**

###### **Neni 3**

Tatimi mbi vlerën paguhet për pronën e patundshme, përveç për atë pronë e cila është liruar nga pagimi i tatimit sipas këtij ligji.

##### **I detyruari tatimor**

###### **Neni 4**

(1) I detyruar tatimor mbi pronën është personi juridik dhe fizik pronar i pronës.

(2) I detyruar tatimor mbi pronën është personi juridik dhe fizik shfrytëzues i pronës, në rastet kur pronari nuk është i njohur ose i pakapshëm.

(3) I detyruar tatimor mbi pronën mund të jetë edhe frutshrytëzuesi i pronës në pajtim me ligjin.

(4) Nëse prona është në pronësi të më shumë personave çdonjëri prej tyre është i detyruar tatimor mbi pronën në proporcion me pjesën pronësore.

(5) I detyruari tatimor mbi pronën është edhe personi juridik dhe fizik - shfrytëzues i pronës së patundshme në pronësi të shtetit dhe të komunës.

##### **Baza tatimore**

###### **Neni 5**

(1) Bazë për tatimin mbi pronën paraqet vlera e tregut e pronës së patundshme.

(2) Përcaktimin e vlerës tregtare të pronës së patundshme e kryen personi vlerësues që është i punësuar në njësinë e vetadministrimit lokal, e më kërkuesë të njësisë së vetadministrimit lokal, mund ta kryejë edhe personi që është vlerësues i autorizuar.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, në rastet e përcaktimit të tatimit mbi qarkullim të patundshmërive për qëllimet e procedurës nga nenet 38-a, 38-b, 38-v, 38-g dhe 38-d të këtij ligji, kurse me kërkesë të detyrësit përcaktimin e vlerës së tregut e kryen vlerësuesi i autorizuar.

(4) Vlera e tregut nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet sipas Metodologjisë për vlerësimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme.

(5) Kontrollin dhe revizionin për përcaktimin e vlerës së tregut nga paragrafi 2 i këtij neni, e bën Ministria e Financave.

(6) Revizionin e përcaktimit të vlerës së tregut nga paragrafi (3) i këtij neni me kërkesë e kryhen Komisioni për Revizion të Vlerësimit i Odës për Vlerësues.

## **Normat e tatimit**

### **Neni 6**

(1) Normat e tatimit mbi pronën nga neni 3 i këtij ligji janë proporcionale dhe paraqesin prej 0,10% deri më 0,20%.

(2) Normat e tatimit mbi pronën mund të përcaktohen sipas llojit të pronës.

(3) Norma e tatimit mbi pronën për tokën bujqësore e cila nuk shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore, mund të rriten prej tri deri më pesë herë në raport me normat e përshkruara në paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Lartësinë e normave nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunës.

(5) Lartësinë e normave nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunave në Qytetin e Shkupit dhe këshilli i Qytetit të Shkupit në pajtim me Ligjin për Qytetin e Shkupit.

## **Krijimi i detyrimit tatimor**

### **Neni 7**

Obligimi tatimor për tatimin mbi pronën krijohet me ditën e fitimit të pronës, dhënien e lejes për përdorimin e pronës së patundshme nga organi kompetent ose me ditën e fillimit të shfrytëzimit të pronës nga i detyruari tatimor.

## **Të liruarit dhe lehtësimet tatimore**

### **Neni 8**

Tatim mbi pronën nuk paguhet për:

1) pronën e patundshme në pronësi shtetërore të cilën e shfrytëzojnë organet shtetërore, pronën e patundshme në pronësi të komunës të cilën e shfrytëzojnë organet e komunës, organet e komunave në Qytetin e Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit, përveç pronës së patundshme e

- cila shfrytëzohet nga personat fizikë ose juridikë;
- 2) pronën e patundshme të përfaqësive të huaja diplomatike dhe konzulare dhe përfaqësive të organizatave ndërkombëtare, nëse janë në pronësinë e tyre, me kusht të reciprocitetit;
- 3) pronën e patundshme në pronësi të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë;
- 4) objekte fetare në të cilat kryhet liturgji, lutje dhe manifestime tjera të fesë si tempull, xhami, shtëpi për lutje, sinagogë, varreza dhe hapësira tjera të kishës, komunitetit fetar dhe grupit religjioz;
- 5) ndërtime individuale që me akt për mbrojtje janë shpallur për trashëgimi kulturore.
- 6) objektet për mbrojtjen e tokës, ujërave dhe ajrit;
- 7) objektet e ndërmarrjeve për aftësimin punues, rehabilitimin profesional dhe punësimin e invalidëve;
- 8) tokën e cila shfrytëzohet për mihje sipërfaqësore dhe nëntokësore në xehetari dhe për hulumtimet gjeologjike;
- 9) objekte të dedikuara për përpunimin primar të prodhimeve bujqësore si vijon:
- objekte të dedikuara për rritjen e bagëtisë dhe peshqve,
  - objekte për vendosjen e pajisjes për ndjekjen e cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve primare blegtorale dhe bujqësore të ekonomisë bujqësore,
  - objekte për vendosjen dhe mirëmbajtjen e mekanizimit bujqësor, pajisjes së rimorkiuar dhe mjeteve tjera për transport dhe pajisjes së ekonomisë bujqësore,
  - objekte për magazinim, pranim, ruajtje dhe paketim të prodhimeve primare bujqësore dhe shtazore dhe ushqimit për kafshë të ekonomisë bujqësore,
  - objekte, qendra për grumbullimin e qumështit, kërpudhave dhe bimëve mjekuese,
  - rezervuare për ujë të lidhura me aktivitetet në prodhimin bujqësor të ekonomisë bujqësore dhe
  - objekte për trajtimin e hedhurinave nga aktivitetet në prodhimin bujqësor të ekonomisë bujqësore.
- 10) tokën bujqësore e cila shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

## **Neni 9**

I detyruari tatimor mbi pronën për ndërtesën strehimore ose banesën, në të cilën jeton me anëtarët e familjes, ka të drejtë në zvogëlimin e tatimit të llogaritur në lartësi mbi 50%.

## **2. TATIMI MBI TRASHËGIMINË DHE DHURATËN**

### **Lënda e tatimit**

#### **Neni 10**

(1) Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën paguhet për pronë të patundshme dhe të drejtën e frutshfrytëzimit dhe shfrytëzimit të pronës së patundshme, të cilat trashëgimtarët përkatësisht pranuesit e dhuratave i trashëgojnë, përkatësisht marrin në bazë të Ligjit për trashëgimi, përkatësisht marrëveshjes për dhuratë.

(2) Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën paguhet edhe për para të gatshme, kërkesa në para, letra me vlerë dhe pronë tjetër të patundshme, nëse vlera e tregut e trashëgimisë, përkatësisht marrëveshjes për dhuratë është më e lartë se shuma njëvjeçare e rrogës mesatare në Republikën e

Maqedonisë në vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikës.

(3) Vlera e të gjitha dhuratave nga paragrafi (2) i këtij neni i të njëjtit lloj, të pranuar gjatë një viti kalendarik, paraqet një bazë tatimi.

(4) Për vlerën e dhuratave komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit mban e evidencë, në bazë të së cilës, në fund të vitit pranuesi i dhuratave mund të ngarkohet me tatim, nëse gjatë vitit pranon më shumë dhurata të të njëjtit lloj dhe në lartësinë e shumës së përshkruar në paragrafin (2) të këtij neni.

(5) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (4) i këtij neni e përshkruan ministri i Financave.

## **I detyruari tatimor**

### **Neni 11**

(1) I detyruari tatimor mbi trashëgiminë dhe dhuratën është person - rezident fizik dhe juridik i Republikës së Maqedonisë i cili trashëgon pronë nga neni 10 i këtij ligji, si dhe personi fizik dhe juridik i cili pranon dhuratë në vend dhe në botë.

(2) I detyruar tatimor mbi trashëgiminë dhe dhuratën është edhe personi - rezident i huaj fizik dhe juridik për pronën e patundshme dhe të tundshme të cilën e trashëgon, përkatësisht e pranon dhuratë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 12**

(1) Nëse trashëgimtari i cili ka pranuar të jetë trashëgimtar, e lë trashëgiminë në dobi të personit i cili do të mund të vinte te kjo trashëgimi dhe në rast kur trashëgimtari nuk do t'ia kishte lënë, tatimin e paguan personi në pronësi të të cilit kalon prona e trashëguar.

(2) Nëse trashëgimtari i lë trashëgimi personit të caktuar, i cili do të vinte te trashëgimia në rast se trashëgimtari nuk do t'ia kishte lënë, atëherë trashëgimtari që e ka lënë trashëgiminë paguan tatim mbi trashëgiminë, kurse personi në dobi të të cilit është lënë trashëgimia paguan tatim mbi dhuratën.

## **Baza e tatimit**

### **Neni 13**

Bazë për tatim mbi trashëgiminë dhe dhuratën paraqet vlera e tregut e pronës së trashëguar, përkatësisht e dhuratës pronë e pranuar në momentin e krijimit të detyrimit tatimor, të zvogëluar për borxhet dhe shpenzimet të cilat e ngarkojnë pronën e cila është lëndë tatimi.

### **Neni 14**

Vlera e tregut e pronës së trashëguar ose si dhuratë e pronës së pranuar rregullohet sipas Metodologjisë nga neni 5 paragrafi (4) i këtij ligji.

## **Krijimi i detyrimit tatimor**

### **Neni 15**

- (1) Obligimi tatimor lidhur trashëgiminë krijohet në momentin e plotfuqishmërisë së vendimit për trashëgimi.
- (2) Obligimi tatimor lidhur me dhuratën krijohet me ditën e lidhjes së marrëveshjes për dhuratë.
- (3) Nëse prona e patundshme e cila është lëndë e trashëgimisë, përkatësisht dhuratës, është e ngarkuar me të drejtën e frutshfrytëzimit, obligimi i trashëgimisë dhe dhuratës krijohet pas ndërprerjes së të drejtës për frutshfrytëzim.
- (4) Nëse me ligj ndalohej shitja e lëndës së trashëguar, përkatësisht dhuratës së pranuar si pronë e patundshme nga neni 10 paragrafi (2) i këtij ligji, obligimi tatimor krijohet me ditën e plotfuqishmërisë së vendimit të lejes për shitje, përkatësisht ditës së shitjes.
- (5) Nëse vendimi i plotfuqishëm për trashëgimi ose marrëveshja për dhuratë nuk janë paraqitur me kohë, obligimi tatimor krijohet në ditën e zbulimit të pronës së trashëguar, përkatësisht të pronës së pranuar dhuratë.

## **Norma tatimore**

### **Neni 16**

- (1) Normat e tatimit mbi trashëgiminë dhe dhuratën janë proporcionale dhe dalluese varësisht nga rendi trashëgues.
- (2) Tatimi për trashëgimi dhe dhuratë për të detyruar nga rendi i dytë trashëgues llogaritet me normën prej 2% deri më 3%, kurse për trashëgimtarin e rendit të tretë trashëgues ose të detyruarit i cili nuk është në faqefisni me trashëgimlënësin, tatimi llogaritet me normën prej 4 deri më 5%.
- (3) Lartësinë e normave nga paragrafi (2) i këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunës.
- (4) Lartësinë e normave nga paragrafi (2) i këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunave në Qytetin e Shkupit dhe këshilli i Qytetit të Shkupit në pajtim me ligjin për Qytetin e Shkupit.

## **Lirimet tatimore**

### **Neni 17**

Tatim mbi trashëgiminë dhe dhuratën nuk paguan:

- 1) Trashëgimtar, përkatësisht pronari i dhuratës nga rendi i parë trashëgues;
- 2) Trashëgimtar, përkatësisht pranuesi i dhuratës nga rendi i dytë trashëgues të një banese të trashëguar përkatësisht të banesës së pranuar dhuratë, përkatësisht ndërtesës strehimore familjare nëse me trashëgimlënësin përkatësisht dhënësin e dhuratës ka jetuar në familje të përbashkët së paku një vit para vdekjes së trashëgimlënësit, përkatësisht në momentin e pranimit të dhuratës, me kusht që ai dhe anëtarët e familjes së tij të mos kenë banesë tjetër përkatësisht ndërtesë tjetër strehimore dhe
- 3) Trashëgimtar, përkatësisht pranuesi i dhuratës nga rendi i dytë trashëgues i cili bujqësinë e ka veprimtari themelore që do ta trashëgojë, nëse me trashëgimlënësin, përkatësisht dhënësin e dhuratës ka jetuar në

familje të përbashkët së paku një vit para vdekjes së trashëgimlënësit, përkatësisht në momentin e pranimit të dhuratës.

## **Neni 18**

Nga tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën lirohen organet shtetërore, organet e komunave, organet e komunave në Qytetin e Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, organizatat e Kryqit të Kuq, institucionet humanitare, sociale, shkencore, arsimore, kulturore dhe bashkësitë fetare për dhuratën që e kanë pranuar si pronë të patundshme ose të tundshme, letrave me vlerë, mjeteve në para dhe kërkesave.

# **3. TATIMI MBI QARKULLIM I PATUNDSHMËRIVE**

## **Lënda e tatimit**

### **Neni 19**

(1) Për qarkullimin e realizuar të patundshmërive paguhet tatim mbi qarkullimin e patundshmërive. Si qarkullim i patundshmërive sipas këtij ligji, konsiderohet bartja me kompensim dhe pa kompensim e të drejtës së pronësisë, si dhe mënyra tjetër e fitimit të patundshmërive me kompensim dhe pa kompensim ndërmjet personave juridikë dhe fizike.

(2) Si qarkullim i patundshmërive nuk konsiderohet ndarja fizike e pronës së patundshme.

## **I detyruari tatimor**

### **Neni 20**

(1) I detyruari tatimor mbi tatimin në qarkullim të patundshmërive është personi juridik dhe fizik - shitës i patundshmërisë.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, i detyruari i tatimit në qarkullim të patundshmërive mund të jetë personi juridik dhe fizik, blerës i patundshmërisë, nëse në kontratën për shitblerjen e patundshmërisë është bërë marrëveshje që tatimin ta paguajë blerësi.

(3) Gjatë zëvendësimit të patundshmërive i detyruar tatimor është pjesëmarrësi në zëvendësimin i cili jep në zëvendësim patundshmëri me vlerë të madhe.

(4) Nëse transferohet pjesë ideale e pronësisë së patundshmërisë, i detyruar tatimor është çdo pronar veçmas.

(5) Nëse e drejta për pronësi të patundshmërisë transferohet në bazë të marrëveshjes për përkujdesje të përjetshme, i detyruar tatimor është pranuesi i patundshmërisë, përkatësisht trashëgimtarët e tij.

(6) Gjatë shitjes së patundshmërisë në procedurë falimentuese dhe ekzekutive, si dhe gjatë realizimit të marrëveshjeve për hipotekë, i detyruar tatimor mund të jetë edhe blerësi i patundshmërisë.

## **Baza tatimore**

## Neni 21

- (1) Bazë e tatimit mbi qarkullim të patundshmërive është vlera e tregut të patundshmërisë në momentin e krijimit të detyrimit.
- (2) Gjatë zëvendësimit të patundshmërive bazë tatimore është ndryshimi i vlerave të tregut të patundshmërive të cilat zëvendësohen.
- (3) Gjatë transferit të pjesës ideale të pronësisë së patundshmërisë, bazë tatimore është vlera e tregut të pjesës ideale të patundshmërisë.
- (4) Gjatë shitjes së patundshmërisë në procedurë falimentuese dhe ekzekutive, bazë tatimore është çmimi i arritur i shitjes përmes ankandit publik ose me marrëveshje të drejtpërdrejtë nëse pas dy procedurave të zbatuara të njëpasnjëshme të ankandit publik nuk është realizuar shitja e patundshmërisë.
- (5) Gjatë realizimit të shitjes së pronës së patundshme në procedurën e ankandit publik të realizuar nga organet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, baza tatimore është çmimi i arritur i shitjes në procedurën e ankandit publik.
- (6) Vlera e tregut caktohet sipas Metodologjisë nga neni 5 paragrafi (4) i këtij ligji.

## Normat tatimore

### Neni 22

- (1) Normat e tatimit mbi qarkullim të patundshmërive janë proporcionale dhe paraqesin prej 2% deri 4%.
- (2) Lartësinë e normave nga paragrafi (2) i këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunës.
- (3) Lartësinë e normave nga paragrafi (1) i këtij neni me vendim e përcakton këshilli i komunave në Qytetin e Shkupit dhe këshilli i Qytetit të Shkupit në pajtim me ligjin për Qytetin e Shkupit.

## Krijimi i detyrimit tatimor

### Neni 23

- (1) Obligimi tatimor i tatimit mbi qarkullim të patundshmërive krijohet me ditën e lidhjes së marrëveshjes për transferin e të drejtës së pronësisë të patundshmërive, përkatësisht zëvendësimit të patundshmërive.
- (2) Nëse nuk është lidhur marrëveshje fuqiplote në kuptim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, obligimi tatimor krijohet në ditën kur blerësi, përkatësisht pjesëmarrësi në zëvendësim, është bërë pronar i patundshmërisë.
- (3) Nëse transferi i të drejtës së pronësisë bëhet në bazë të vendimit të gjykatës ose organit tjetër shtetëror, obligimi tatimor krijohet në ditën e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.
- (4) Nëse bëhet transferi i të drejtës së pronësisë të objekteve ndërtimore të cilat janë në ndërtim, obligimi tatimor krijohet në ditën e dorëzimit të objektit blerësit.



(5) Nëse marrëveshja për qarkullim të patundshmërisë ose vendimi i gjykatës nuk janë paraqitur ose nuk janë paraqitur në kohë, obligimi tatimor krijohet në ditën e zbulimit të qarkullimit të bërë.

## Neni 24

Nëse transferi i pronësisë së patundshmërisë bëhet në bazë të marrëveshjes për përkujdesje të përjetshme, obligimi tatimor krijohet në momentin e vdekjes së pranuesit të përkujdesjes.

## Lirimet tatimore

## Neni 25

Tatimi mbi qarkullim të patundshmërive nuk paguhet:

- 1) mbi qarkullimin e patundshmërive në procedurën e ekspropriimit;
- 2) kur përfaqësia e huaj diplomatike, përkatësisht konsulare e transferon të drejtën e pronësisë së patundshmërive, me kusht të reciprocitetit;
- 3) kur e drejta e pronësisë transferohet për shkak të mbulimit të obligimeve në bazë të të hyrave publike në procedurën për arkëtim të detyrueshëm;
- 4) mbi qarkullimin e patundshmërive ndërmjet organeve shtetërore, ndërmjet organeve shtetërore dhe komunave dhe ndërmjet komunave;
- 5) të qarkullimit të patundshmërive në procedurën e konfiskimit;
- 6) të qarkullimit të banesave në pronësi shoqërore, nëse në marrëveshjen e shitblerjes nuk është rregulluar se obligim i kujt është pagimi i tatimit;
- 7) kur e drejta e pronësisë së patundshmërisë u bartet organeve shtetërore për arkëtim të kërkesave në procedurë të falimentimit dhe përmbarimit
- 8) kur e drejta e pronësisë së patundshmërisë i transferohet dhënësit të përkujdesjes së përjetshme i cili në raport me pranuesin e përkujdesjes gjendet në rendin e parë trashëgues edhe atë vetëm për pjesën e patundshmërisë i cili do ta trashëgonte sipas Ligjit për trashëgimi dhe pa dhënë përkujdesje;
- 9) mbi qarkullimin e parë të ndërtesave strehimore dhe banesave i cili do të bëhet në periudhën deri më pesë vjet pas ndërtimit për të cilin është llogaritur vlera e shtuar;
- 10) gjatë investimit të patundshmërive në kapitalin e shoqërive tregtare;
- 11) mbi tregtimin me letra me vlerë në kuptim të Ligjit për letra me vlerë dhe
- 12) kur e drejta e pronësisë së patundshmërisë u transferohet bankave si kreditorë, për shkak të arkëtimit të kërkesave në para, nëse në afat prej 3 vjetësh e shesin pronën e fituar.

## PJESA E TRETË

## PËRCAKTIMI DHE ARKËTIMI I TATIMEVE MBI PRONËN

### 1. PËRCAKTIMI DHE ARKËTIMI

## Neni 26

(1) Përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve mbi pronën nga neni 1 i këtij ligji e bën komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në rajonin e komunës ku gjendet prona.

(2) Nëse prona gjendet në rajonin e dy ose të më shumë komunave, tatimin e përcakton komuna për vlerësimin e pronës e cila gjendet në rajonin e komunës përkatëse.

(3) Për pronën e trashëguar të patundshme, përkatësisht pronën e patundshme të dhuruar, tatimin e përcakton komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit ku gjendet vendbanimi i të detyruarit tatimor.

(4) Vendim për tatimin e përcaktuar nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni merr prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit.

## **Neni 27**

Tatimi mbi pronën përcaktohet në bazë të të dhënave nga fletëparaqitja tatimore, librat tatimorë të të detyruarve dhe të dhënat tjera me të cilat disponon komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

## **Neni 28**

Përmbajtjen e fletëparaqitjes tatimore nga neni 27 i këtij ligji e përshkruan ministri i Financave.

## **Neni 29**

(1) I detyruari i tatimit mbi pronën është i obliguar të paraqesë fletëparaqitje deri më 31 janar në vitin për të cilin bëhet përcaktimi i tatimit.

(2) I detyruari i tatimit mbi pronën nga paragrafi (1) i këtij i cili ka paraqitur fletëparaqitje tatimore nuk ka për obligim për të njëjtën pronë të paraqesë fletëparaqitje të re, nëse nuk ka ndryshime të të dhënave të përmbajtura në fletëparaqitjen paraprake tatimore, por që kanë ndikim për lartësinë e detyrimit tatimor.

(3) Për pronën të cilën e fiton ose fillon ta shfrytëzojë gjatë vitit ose nëse sipas ndonjë baze tjetër krijohet obligimi tatimor, i detyruari ka për detyrë të paraqesë fletëparaqitje tatimore në afat prej 15 ditësh nga dita e fitimit të pronës, ose nga fillimi i shfrytëzimit të pronës, përkatësisht nga krijimi i detyrimit tatimor.

(4) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni i dedikohet komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit ku gjendet prona.

## **Neni 30**

Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit merr vendim për lartësinë e tatimit mbi pronën më së voni deri më 31 mars në vitin në të cilin përcaktohet tatimi mbi pronën dhe i dërgon vendim të detyruarit tatimor për tatimin e përcaktuar.

## **Neni 31**

(1) I detyruari i tatimit të trashëgimisë dhe dhuratës është i detyruar të paraqesë fletëparaqitje tatimore në afat prej 15 ditësh nga dita e krijimit të detyrimit tatimor nga neni 15 i këtij ligji.

(2) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni i dedikohet komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ku gjendet prona e

patundshme të cilën i detyruari e trashëgon ose e pranon dhuratë.

(3) Nëse i detyruari trashëgon ose pranon dhuratë pronë të patundshme, fletëparaqitja i dedikohet komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ku i detyruari e ka vendbanimin.

### **Neni 32**

Gjykata ka për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për trashëgimi, t'ia dërgojë vendimin komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ku gjendet prona e trashëguar.

### **Neni 33**

(1) Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit merr vendim për lartësinë e tatimit mbi trashëgiminë dhe dhuratën më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes tatimore dhe të detyruarit tatimor i dërgon vendim për tatimin e përcaktuar.

### **Neni 34**

(1) I detyruari i tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive është i detyruar të paraqesë fletëparaqitje tatimore në afat prej 15 ditësh nga dita e krijimit të detyrimit tatimor nga neni 23 i këtij ligji.

(2) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni i dedikohet komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ku gjendet prona e patundshme.

### **Neni 35**

Pa dëshminë për tatimin e paguar dhe pa vendimin gjyqësor, deklarinimin e palëve ose me akt tjetër, nuk mund të bëhet regjistrimi i marrëveshjes për transferin e pronësisë së patundshmërisë te noteri ose te gjykata kompetente, ose regjistrimi i transferit të së drejtës për pronësi të patundshmërisë në librat e kadastrit dhe në libra tjerë publikë.

### **Neni 36**

(1) Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit merr vendim për lartësinë e tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive në afat jo më të gjatë se dhjetë ditë nga dita e pranimit të fletëparaqitjes tatimore dhe të detyruarit tatimor përkatësisht blerësit të patundshmërisë i dërgon vendim për tatimin e përcaktuar.

### **Neni 37**

Tatimi mbi pronën paguhet në tre muaj dhe arrin për arkëtim në mesin e çdo tremujori ose në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të vendimit.

### **Neni 38**

Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratat dhe tatimi mbi qarkullimin e patundshmërive paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të vendimit për obligimin e caktuar tatimor.

# 1-A PËRCAKTIMI DHE ARKËTIMI I TATIMIT MBI QARKULLIM TË PATUNDSHMËRIVE, NË BAZË TË MARRËVESHJES SË LIDHUR PËR SHITBLERJE TË PRONËS SË PATUNDSHME NË PROCEDURË TË VEÇANTË

## Neni 38-a

Palët kontraktuese që kanë lidhur marrëveshje për shitblerje të pronës së patundshme mund të zgjedhin procedurë të veçantë për përcaktimin e tatimit mbi qarkullim për patundshmëritë, që e organizon noteri kompetent, sipas zonës në të cilën gjendet prona e patundshme.

## Neni 38-b

(1) Për zbatimin e procedurës nga neni 38-a të këtij ligji, detyrësi noterit i dorëzon raport për përcaktimin e vlerës së tregut të patundshmërisë dhe llogaritje të tatimit akontativ të qarkullimit të hartuara nga vlerësuesi i autorizuar, si dhe fletëparaqitje tatimore akontative të plotësuar.

(2) Noteri në formë elektrike siguron aktzotërim me të dhënat për patundshmëritë në të cilën përfshihen edhe të dhënat për hipoteka dhe ngarkesa tjera, certifikatë nga gjendja rrjedhëse nëse tatimpaguesi është personi juridik dhe e organizon lidhjen e marrëveshjes së shitblerjes.

(3) Formën dhe përmbajtjen e raportit, llogaritjen dhe fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Financave.

## Neni 38-v

(1) Në bazë të fletëparaqitjes tatimore akontative, vlerësimit të hartuar dhe llogaritjes akontative të tatimit mbi qarkullim, tatimpaguesi kryen pagesë të tatimit mbi qarkullim për patundshmërinë në llogari të veçantë depozitore në noter, për pagesën e tatimit akontativ mbi qarkullim.

(2) Pas pagesës, noteri kryen bartjen e shumës së arkëtuar të tatimit mbi qarkullim të patundshmërive në llogari përkatëse pagesore të njësisë kompetente të vetëqeverisjes lokale.

## Neni 38-g

(1) Noteri e solemnizon marrëveshjen për shitblerje apo e harton në formë të aktit të noterit dhe në të vë klauzolë se është paguar tatimi akontativ mbi qarkullim të patundshmërisë.

(2) Dokumentacionin e plotë nga procedura, noteri e dorëzon te Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive të Republikës së Maqedonisë në formë elektronike, e cila me zbatimin e të drejtës së pronësisë së patundshmërisë në librat publikë në afat prej një ditë pune tërë dokumentacionin e dorëzon te njësia kompetente e vetëqeverisjes lokale në formë elektronike.

(3) Procedurën për sigurimin e dokumenteve nga neni 38-b paragrafi (2) të këtij ligji, bartjen e pagesës së shumës nga neni 38-v paragrafi (2) të këtij ligji, solemnizimin e marrëveshjes për shitblerje apo aktin e noterit nga neni 38-g paragrafi (1) të këtij ligji, si dhe dorëzimin e dokumentit te

Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive të Republikës së Maqedonisë, noteri kompetent i kryen në afat jo më të gjatë se dy ditë pune.

(4) Në rast nga paragrafi (3) i këtij neni, noteri vepron në afatin e paraparë nga paragrafi (2) i këtij neni, vetëm nëse detyrësi e ka paguar shpërblimin e noterit dhe të gjitha shpenzimet në procedurë para noterit.

### **Neni 38-d**

(1) Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga neni 38-g paragrafi (3) të këtij ligji, njësia kompetente e vetëqeverisjes lokale kryen kontrollin për shumën e llogaritur të tatimit të paguar akontativ mbi qarkullim të patundshmërisë dhe miraton aktvendim tatimor.

(2) Nëse komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, përcakton se vlera e tregut e patundshmërisë dhe shumës akontative e tatimit mbi qarkullim nuk janë llogaritur drejtë nga vlerësuesi i autorizuar, parashtron kërkesë për revizion të vlerësimit të Komisioni për Revizion të Vlerësimit në Odën për Vlerësues.

(3) Tatimin e përlllogaritur mbi qarkullim të patundshmërive të përcaktuar në aktvendimin tatimor të miratuar nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, tatimpaguesi do ta paguajë sipas dispozitave të këtij ligji.

(4) Kundër aktvendimit tatimor nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

## **2. REGJISTRI I PRONËS SË PATUNDSHME DHE REGJISTRI I PRONËS SË TUNDSHME**

### **Neni 39**

(1) Komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit mbajnë regjistër të pronës së patundshme dhe regjistër të pronës së tundshme të cilat i nënshtrohen tatimit.

(2) Komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit e harmonizon rregullisht gjendjen e regjistrit të patundshmërive me regjistrin të cilin e mban Enti shtetëror për punë gjeodete.

(3) Komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit çdo vjet e më së voni deri më 31 dhjetor në atë vit, të dhënat nga gjendja e regjistrave nga paragrafi (1) i këtij neni ia dërgon Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe Drejtorisë për të hyra publike - Drejtoria e përgjithshme.

(4) Ministri i Financave përshkruan formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të patundshmërive dhe regjistrit të pronës së tundshme.

## **3. SHTYRJA E EKZEKUTIMIT**

### **Neni 40**

(1) Me kërkesën e të detyruarit tatimor, prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, mund ta

shtyjnë ekzekutimin e vendimit, përkatësisht të lejojnë pagesën me shtyrje të obligimeve ose pagesën në këste.

(2) Shtyrja e ekzekutimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të lejohet nëse i detyruari tatimor e siguron pagimin e borxhit tatimor me instrument për sigurimin e pagesës.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës së obliguesit tatimor nga paragrafi (1) të këtij neni e përcakton ministri i Financave.

## 4. PROCEDURA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË BORXHIT TATIMOR, PÛRKATËSISHT DETYRIMIT TATIMOR

### Neni 41

Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit do ta shtyjnë ekzekutimin e vendimit për borxh tatimor, përkatësisht pagimin e detyrimit tatimor nëse i detyruari tatimor deponon garanci bankare, paguan depozitë të gatshme ose siguron instrument tjetër për sigurimin e pagimit (në tekstin e mëtejme: instrument për sigurimin e pagimit), përpos për borxhin tatimor, përkatësisht obligimin tatimor më të vogël se 10.000,00 denarë.

### Neni 42

Pagimi i detyrimit tatimor mund të lejohet në 12 këste mujore.

### Neni 43

(1) Për sigurimin e pagimit të borxhit tatimor, përkatësisht të detyrimit tatimor mund të kërkohet vetëm një instrument për siguri.

(2) Instrumentin për siguri i detyruari tatimor ia dërgon komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, me kërkesën për shtyrjen e borxhit tatimor, përkatësisht detyrimit tatimor.

### Neni 44

(1) Vlera e instrumentit për sigurimin e pagimit duhet t'i përgjigjet lartësisë së borxhit tatimor, përkatësisht detyrimit tatimor.

(2) Vlera e depozitës së gatshme duhet t'i përgjigjet ½ të borxhit tatimor, përkatësisht detyrimit tatimor.

### Neni 45

(1) Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, do ta shtyjnë pagesën e borxhit tatimor, përkatësisht të detyrimit tatimor duke pasur parasysh rregullsinë e të detyruarit tatimor gjatë mbulimit të obligimeve tatimore.

(2) Shtyrja e pagesës së borxhit tatimor, përkatësisht detyrimit tatimor nuk lejohet nëse është marrë vendim për pagesë të detyrueshme.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni me të cilën refuzohet kërkesa për anulimin e pagesës së borxhit tatimor, si dhe kundër

aktvendimit të miratuar sipas kërkesës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji, mund të ngrihet kontesti administrativ para gjykatës administrative.

### **Neni 46**

Me dhënien e garancisë bankare, banka - garantuese obligohet se të detyruarit tatimor do t'ia mbulojë borxhin tatimor, përkatësisht obligimin tatimor, e në të kundërtën, se borxhin përkatësisht obligimin do ta mbulojë banka në vend të të detyruarit tatimor.

### **Neni 47**

Garancia bankare si instrument për siguri arkëtohet në para të gatshme në pajtim me dispozitat të cilat vlejné për arkëtimin e garancive bankare.

### **Neni 48**

I detyruari tatimor është i obliguar që kërkesës t'ia bashkëngjisë dëshminë për depozitën e paguar në para të gatshme në llogari të veçantë depozite të komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

### **Neni 49**

Për depozitën e paguar në para të gatshme nuk paguhet interes.

### **Neni 50**

Nëse i detyruari tatimor nuk bën pagimin e borxhit tatimor, përkatësisht të detyrimit tatimor në afatin e lejuar për pagesë të shtyrë, përkatësisht nuk paguan dy këstet e fundit në rast të pagesës së lejuar në këste të borxhit tatimor, përkatësisht të detyrimit tatimor, borxhi, përkatësisht obligimi arkëtohet nga depozita në para të gatshme, përkatësisht nga instrumenti i deponuar për sigurimin e pagesës.

### **Neni 51**

(1) Nëse i detyruari tatimor e ka mbuluar borxhin tatimor, përkatësisht detyrimin tatimor të cilin e ka siguruar me instrumentin për sigurimin e pagesës, instrumenti për sigurimin e pagesës i kthehet.

(2) I detyruari tatimor, në bazë të kërkesës, mund ta tërheqë depozitën në para të gatshme nëse për borxhin tatimor, përkatësisht për detyrimin tatimor deponon instrument për sigurimin e pagesës.

## **5. PADIA**

### **Neni 52**

(1) Kundër aktvendimit të kryetarit të komunës, kryetarit të komunës në qytetin e Shkupit dhe kryetarit të qytetit të Shkupit mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(2) Padia nuk e anulon arkëtimin e tatimit të përcaktuar.

(3) Kontesti administrativ mund të ngrihet edhe kur kryetari i komunës, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit, me kërkesë të tatimpaguesit nuk ka miratuar aktvendim në afatin e përcaktuar me ligj.

## Neni 52-a

I fshirë 2

# 6. PAGESA E DETYRUESHME

## Neni 53

Arkëtimin e borxhit të arritur tatimor, dënimet në para dhe interesat të cilat i detyruari tatimor nuk i ka paguar vullnetarisht në afatin e caktuar, komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit do ta bëjë me detyrim (në tekstin e mëtejme: pagesa e detyrueshme).

## Neni 54

Para se të fillohet me pagesën e detyrueshme, komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, i dërgojnë të detyruarit tatimor vërejtje me shkrim që t'i paguajë borxhin doganor, dënimet në para dhe interesin në afat prej tetë ditësh nga dita e dërgimit të vërejtjes në adresën e fundit të cilën e ka paraqitur te ata.

## Neni 55

(1) Pagesa e detyrueshme e borxhit tatimor, dënimi në para dhe kamata bëhet në bazë të vendimit për pagesën e detyrueshme, të cilin e merr prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, ku gjendet prona e të detyruarit tatimor.

(2) Vendimi për arkëtimin e detyrueshëm personalisht i dërgohet të detyruarit tatimor.

(3) Në vendimin për arkëtimin e detyrueshëm thuhet: lartësia e borxhit, mënyra e realizimit të arkëtimit të detyrueshëm dhe vërejtja se shpenzimet e arkëtimit të detyrueshëm do të biejn mbi të detyruarin tatimor.

## Neni 56

(1) Shpenzimet në procedurën për arkëtimin e detyrueshëm biejnë mbi të detyruarin tatimor edhe atë:

- 4% e shumës së kryeborxhit dhe interesi gjatë kryerjes së regjistrimit dhe
- 5% e shumës së kryeborxhit dhe interesi gjatë kryerjes shitjes.

(2) Përveç shpenzimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, i detyruari tatimor i mbulon edhe shpenzimet për çdo dalje të personit zyrtar të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit në lidhje me regjistrimin dhe shitjen. Shumën e këtyre shpenzimeve e përcakton prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit.

(3) Shpenzimet tjera (shpenzimet për ruajtjen dhe transportin e sendeve dhe ngjashëm), biejnë mbi të detyruarin tatimor në shumën reale.

(4) Llogaritësve dhe dëshmitarëve u takon kompensim për një orë që bie mbi të detyruarin tatimor. Shumën e shpenzimit e cakton prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupi dhe prefekti i Qytetit të Shkupit.



## Neni 57

(1) Pagesa e detyrueshme e borxhit tatimor bëhet nga prona e përgjithshme, të hyrat dhe kërkesat e të detyruarit tatimor përpos:

- 1) veshjes, mbathjes, shtrojës dhe enëve që i janë të domosdoshme të detyruarit tatimor dhe anëtarëve të familjes së tij dhe mobilja më e domosdoshme.
- 2) librave shkencorë dhe profesionalë dhe teksteve të anëtarëve të familjes;
- 3) bursave dhe kredive të nxënësve dhe studentëve;
- 4) shtesave për fëmijë dhe të ardhurave tjera në bazë të mbrojtjes sociale;
- 5) dy të tretave nga të ardhurat personale neto dhe të ardhurat në bazë të sigurimit social dhe
- 6) të ardhurave në bazë për përkujdesje ligjore.

(2) Lëndë e arkëtimit të detyrueshëm nuk mund të jenë as: pajisja zjarrfikëse e destinuar për shfrytëzimin në lokale afariste; ilaçet, ndihmesat mjekësore dhe pajisja mjekësore e destinuar për shfrytëzimin e lokaleve afariste.

## Neni 58

(1) Arkëtimi e detyrueshëm nga prona e të detyruarit tatimor përbëhet nga regjistrimi i vlerësimit dhe shitja e pronës me ankand publik.

(2) Nëse regjistrohen të mira të cilat i nënshtrohen prishjes, përkatësisht afati i përdorimit të së cilave do të kalonte deri në përfundimin e procedurës, shitja mund të bëhet menjëherë me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

## Neni 59

Pagesa e detyrueshme e borxhit tatimor ndërpritet kur i detyruari tatimor do ta mbulojë borxhin me interesat dhe shpenzimet ose kur në mënyrë tjetër do të ndërpritet obligimi për pagesën e borxhit tatimor, për çka ekzekutuesi tatimor harton shënim.

## Neni 60

(1) Kundër aktvendimit për arkëtim të detyrueshëm, tatimpaguesi mund të ngrit kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(2) Në padinë nuk mund të prononcohen rrethanat që kanë të bëjnë me përcaktimin e borxhit tatimor.

(3) Padia nuk e prolongon realizimin e arkëtimit të detyrueshëm.

## Neni 61

(1) Pagesën e detyrueshme të borxhit tatimor, dënimin në para dhe kamatën e bën personi i autorizuar zyrtar në komunën, komunitat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit – ekzekutues tatimor.

(2) Ekzekutuesi tatimor ka legjitimacion zyrtar formën dhe përmbajtjen e së cilës e përcakton ministri i Financave.

(3) Ekzekutuesi tatimor është i detyruar ta tregojë legjitimacionin zyrtar në procedurën e arkëtimit të dhunshëm.

## Neni 62

Kur ekziston dyshim me bazë se ekzekutuesi tatimor do të pengohet të zhvillojë procedurën për arkëtimin e detyrueshëm, mund të kërkojë praninë dhe ndihmën e organit kompetent për rendin publik.

## Neni 63

Regjistrimi sipas rregullit, përfshin pronën, të hyrat dhe kërkesat e të detyruarit tatimor prej të cilit në mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë dhe me më pak shpenzime për të detyruarin tatimor do të sigurohet arkëtimi i borxhit tatimor.

## Neni 64

Regjistrimi i pronës rëndom bëhet në prani të të detyruarit tatimor. Nëse i detyruari tatimor nuk është i pranishëm, regjistrimi bëhet në praninë e dy dëshmitarëve.

## Neni 65

(1) Gjatë regjistrimit ekzekutuesi tatimor bën edhe vlerësimin e pronës. Në rast nevoje, ekzekutuesi tatimor mund të thërrasë edhe person tjetër për vlerësues.

(2) Me kërkesën e të detyruarit tatimor, mund të thirret edhe vlerësues. Shpenzimet për vlerësuesin bien mbi të detyruarin tatimor.

## Neni 66

(1) Për regjistrimin e bërë dhe për vlerësimin e pronës, ekzekutuesi tatimor harton procesverbal në të cilin inkorporohen të gjitha të dhënat dhe hollësitë nga regjistrimi, e veçanërisht:

- emri dhe mbiemri, adresa e të detyruarit tatimor, përkatësisht firma dhe selia afariste e të detyruarit tatimor, si dhe të dhëna për persona tjerë të cilët marrin pjesë në regjistrim dhe vlerësim;
- konstatimi se të detyruarit tatimor i është dërguar vendimi për pagesën e detyrueshme;
- vërejtja se i detyruari tatimor është ftuar ta paguajë borxhin tatimor para fillimit të regjistrimit dhe se ai atë nuk e ka bërë;
- shuma e borxhit tatimor e ekzekutimit të regjistrimit;
- shuma e borxhit tatimor, interesi dhe shpenzimet për të cilat bëhet regjistrimi;
- emri dhe përshkrimi i pronës së regjistruar;
- deklarata e të detyruarit tatimor ose personit të tretë për atë se në pronësinë e kujt është prona që është lëndë e regjistrimit;
- vlera e llogaritur veç e veç e pronës së regjistruar; dhe
- nënshkrimi i personit zyrtar i cili bën regjistrimin, dëshmitarëve dhe vlerësuesit nëse është thirrë.

(2) Një ekzemplar i procesverbalit i dorëzohet të detyruarit tatimor.

## Neni 67

Nëse shuma e borxhit tatimor për të cilin bëhet arkëtimi i detyrueshëm nuk mund të arkëtohet në tërësi nga prona e tundshme e të detyruarit tatimor, arkëtimi i detyrueshëm do të bëhet nga prona e tij e tundshme.

## Neni 68

(1) Nëse i detyruari nuk dëshiron t'i hapë vetë lokalet afariste dhe ta vë në kontroll pronën për kryerjen e regjistrimit dhe vlerësimin, ekzekutuesi tatimor është i autorizuar t'i hapë lokalet e mbyllura në prani të dy dëshmitarëve dhe të bëjë kontrollin në pronën, që të mund të bëjë regjistrimin dhe vlerësimin.

(2) Veprimet e ndërmarra nga paragrafi (1) i këtij neni dhe personat e pranishëm si dëshmitarë në mënyrë të obligueshme shkruhen në procesverbalin për regjistrim.

## Neni 69

(1) Nëse i detyruari tatimor deklaron se prona e cila regjistrohet është në pronësi të një personi të tretë, e nuk jep dëshmi për të, prona do të regjistrohet dhe e njëjta do të shënohet në regjistrin për regjistrim.

(2) Ekzekutuesi tatimor është i detyruar ta informojë personin e tretë nga paragrafi (1) i këtij neni dhe ta udhëzojë se në afat prej tetë ditësh nga dita e informimit mund t'i paraqesë padi për ndarje gjykatës. Nëse ky person në afatin e paraparë nuk paraqet dëshmi se ka ushtruar padi, procedura për arkëtim të detyrueshëm do të vazhdojë.

(3) Nëse personi i tretë i cili disponon të drejtën e pronësisë mbi pronën e regjistruar ka qenë i pranishëm, informohet gojarisht, kurse kjo konstatohet edhe në procesverbal.

(4) Me paraqitjen e dëshmisë për padinë e ushtruar për ndarje shtyhet shitja e sendeve të regjistruara për të cilat është ushtruar padi deri në përfundimin e kontestit dhe kjo pronë i lihet për ruajtje të detyruarit tatimor.

(5) I detyruari tatimor është i obliguar që pronën nga paragrafi (4) i këtij neni ta ruajë në gjendje të pandryshueshme deri në përfundimin e kontestit sipas padisë për ndarje.

## Neni 70

Nëse me padinë për ndarje vërtetohet se paraqitësi i padisë për ndarje nuk është pronar, kurse i detyruari tatimor e tjetërson, zhduk ose e dëmton pronën e regjistruar, kundër tij prokurorisë publike kompetente do t'i dorëzohet fletëparaqitje penale, kurse për arkëtimin e borxhit, pa shtyrje dhe pa dorëzimin e vendimit të posaçëm për caktimin e arkëtimin të detyrueshëm, do të bëhet regjistrimi i ri dhe vlerësimi i pronës së tundshme.

## Neni 71

(1) Prona e regjistruar mund t'i lihet për ruajtje të detyruarit tatimor, me ndalesë për tjetërsim deri në mbulimin e borxhit tatimor. Ndalesën për tjetërsimin e pronës së patundshme, prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupi dhe prefekti i Qytetit të Shkupit ia paraqet organit kompetent për punë gjeodete për shkak të regjistrimit të së drejtës të pengut të parashënuar të patundshmërive.

(2) Nëse i detyruari tatimor e tjetërson, zhduk ose e dëmton pronën e cila i është lënë për ruajtje, kundër tij do t'i paraqitet fletëparaqitje penale prokurorisë publike kompetente.

(3) Paratë e regjistruara, letrat me vlerë, bizhuteritë dhe sendet tjera me vlerë i merren të detyruarit tatimor dhe deponohen në kasafortë në bankë,

kurse të detyruarit tatimor i jepet vërtetim.

## **Neni 72**

Regjistrimi dhe marrja e pronës së patundshme për shkak të arkëtimit të detyrueshëm të borxhit tatimor, me të drejtë nuk bëhet natën, të dielën dhe ditëve të festave fetare dhe shtetërore.

## **Neni 73**

(1) Prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, për shkak të arkëtimit të borxhit tatimor, mund të marrë vendim për ndalimin e shfrytëzimit të mjeteve të të detyruarit tatimor nga llogaritë e tij, të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës dhe kërkesave të tij, kurse bartësit të qarkullim-pagesës, borxhliut të të detyruarit tatimor, përkatësisht pagesit të të ardhurave personale t'u urdhërojë që mjetet t'i paguajnë në dobi të borxhit tatimor.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni tatimpaguesi dhe debitori i tij mund të ngritin kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(3) Padia kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e prolongon arkëtimin sipas aktvendimit.

(4) Në padinë nuk mund të prononcohen rrethanat që kanë të bëjnë me përcaktimin e borxhit tatimor.

(5) Nëse bartësi i qarkullim-pagesës, borxhliu i të detyruarit tatimor ose paguesi i të ardhurave personale nuk veprojnë sipas vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, arkëtimi do të bëhet me detyrim në ngarkesë të mjeteve të tyre.

# **7. SHITJA PUBLIKE**

## **Neni 74**

(1) Shitja publike e pronës së regjistruar dhe të vlerësuar, me të drejtë, bëhet me ankand publik, përpos në rastet nga neni 58 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Ankandi publik thirret me shpallje e cila përmban:

1) emrin, mbiemrin dhe adresën e të detyruarit tatimor;

2) kohën dhe vendin e ankandit publik dhe

3) listën e sendeve të cilat do të ekspozohen në ankandin publik, me përshkrimin dhe shënimin e çmimit fillestar të sendeve që janë objekt i ankandit publik.

## **Neni 75**

Në ankand publik nuk mund të marrin pjesë të punësuarit në komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit si dhe anëtarët e familjeve të tyre.

## **Neni 76**

(1) Ankandi publik ndërpritet posa të arrihet shuma nga sendet e shitura të lëvizshme me të cilat mbulohet borxhi, dënimet në para, interesi dhe

shpenzimet e procedurës, kurse sendet tjera i kthehen të detyruarit tatimor.

(2) Nëse me shitjen e pronës së përcaktuar është realizuar vlerë më e madhe nga shuma e borxhit, dënimet në para, kamatat dhe shpenzimet e procedurës, dallimi do t'i kthehet të detyruarit tatimor.

### **Neni 77**

(1) Për ankandin publik bëhet procesverbal.

(2) Procesverbalin e nënshkruajnë ekzekutuesi dhe blerësi.

### **Neni 78**

Nga shuma e arkëtuar me detyrim mbulohen obligimet sipas rendit vijues:

- 1) shpenzimet e arkëtimit të detyrueshëm;
- 2) tatimi i borxhit dhe të dhënat tjera publike;
- 3) dënimet në para dhe
- 4) interesat e tatimit të borxhit.

## **8. INTERESI PËR TATIMIN E PAGUAR NË KOHË**

### **Neni 79**

Për shumën e tatimit për të cilën nuk është paguar në afatin e përcaktuar, paguhet interes në lartësi prej 0,05% për çdo ditë vonimi.

## **9. GARANCA**

### **Neni 80**

Për arkëtimin e akontacioneve të tatimeve mbi pronën, i detyruari tatimor përgjigjet me tërë pronën e vet.

### **Neni 81**

Nëse i detyruari tatimor e ka tjetërsuar pronën me punë juridike në favor të personit tjetër, që t'i ikë detyrimit për pagimin e tatimit, prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupi dhe prefekti i Qytetit të Shkupit punën e tillë mund ta hedhë poshtë para gjykatës, nëse blerësi ka ditur për qëllimin e tillë të të detyruarit.

### **Neni 82**

(1) Nëse i detyruari tatimor vdes para përcaktimit të lartësisë së detyrimit tatimor, obligimi tatimor u transferohet trashëgimtarëve.

(2) Arkëtimi i detyrimit të përcaktuar do të bëhet nga trashëgimtarët më së shumti deri në lartësinë e vlerës së pronës së trashëguar.

## **10. KTHIMI I TATIMIT TË PAGUAR MË SHUMË OSE TË PAGUAR GABIMISHT**

### **Neni 83**

(1) I detyruari tatimor ka të drejtë për kthimin e tatimit të paguar më shumë ose të gabuar gabimisht, të interesit dhe të shpenzimeve.

(2) Për kthimin e tatimit nga paragrafi (1) i këtij neni vendos në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës prefekti i komunës, prefekti i komunave në Qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit me kërkesën e të detyruarit tatimor.

(3) Nëse i detyruari tatimor nuk paraqet kërkesë për kthimin e shumave të paguara më shumë ose të paguara gabimisht, këto shuma do të llogariten në pagesën vijuese të tatimit.

(4) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës së obliguesit tatimor nga paragrafi (2) të këtij neni i përcakton ministri i Financave.

## 11. PARASHKRIMI

### Neni 84

(1) E drejta për përcaktimin e tatimit parashkruhet për pesë vjet pas përfundimit të vitit në të cilin është dashur të përcaktohet.

(2) E drejta e arkëtimit të tatimit dhe e drejta e arkëtimit të shpenzimeve për arkëtim të detyrueshëm parashkruhet për pesë vjet pas përfundimit të vitit në të cilin është dashur të bëhet arkëtimi.

(3) E drejta e të detyruarit për kthimin e shumave të paguara në mënyrë të padrejtë ose të paguara më shumë në emër të tatimit, interesit dhe shpenzimeve të pagesës parashkruhet për pesë vjet pas përfundimit të vitit në të cilin është bërë arkëtimi.

### Neni 85

(1) Pas çdo ndërprerje të rrjedhës së parashkrimit fillon rrjedha e re e parashkrimit.

(2) E drejta e përcaktimit, pagesës dhe kthimit në çdo rast parashkruhet pas përfundimit të dhjetë vjetëve nga përfundimi i vitit në të cilin është dashur të caktohet, arkëtohet, përkatësisht në të cilin shumat janë paguar.

## 11-A. SHLYERJA E DETYRIMEVE TATIMORE

### Neni 85-a

Me propozimin e kryetarit të komunës, kryetarit të komunave në Qytetin e Shkupit dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit, këshillit të komunës, këshillave të komunave në Qytetin e Shkupit dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, deri në fund të vitit mund të bëjnë shlyerjen e përhershme të detyrimeve tatimore që i kanë në evidencat e tyre në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, nëse ka skaduar afati i parashkrimit ose nëse lartësia e shpenzimeve për arkëtimin e detyrimit tatimor në masë të konsiderueshme e tejkalon lartësinë e detyrimit të paarkëtuar.

## PJESA E PESTË

## 12. MBIKËQYRJA

## Neni 86

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji e bën Ministria e Financave - Drejtoria për të hyra publike.

## Neni 87

(1) Mbikëqyrjen inspektuese mbi përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve mbi pronën e bën inspektori i autorizuar i komunës, inspektori i autorizuar i komunave në Qytetin e Shkupit dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit. (në tekstin e mëtejme: inspektori)

(2) Inspektori nga paragrafi (1) i këtij neni ka legjitimacion, formën dhe përmbajtjen e të cilës e përshkruan ministri i Financave.

(3) Inspektori bën kontrollin e gjendjes dhe të vlerës së pronës së patundshme dhe të tundshme e cila është objekt i tatimit, si edhe punët tjera të caktuara me ligj dhe dispozitë tjetër.

(4) Për ndërmarrjen e veprimeve në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese nga paragrafi (3) i këtij neni inspektori bën procesverbal. I detyruari tatimor ka të drejtë për parashtresë në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së procesverbalit. Nëse në parashtresë paraqiten fakte të reja dhe propozohen dëshmi të reja, për këtë do të formulohet procesverbal plotësues.

(5) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese vërtetohet se i detyruari tatimor nuk e ka paguar ose në mënyrë jo të rregullt e ka paguar tatimin, do t'i urdhërohet që me vendim ta paguajë në afatin e përcaktuar.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(7) Padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## Neni 88

Gjatë mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës, organeve të komunës në Qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit, Ministria e Financave - Drejtoria për të hyra publike i kryen këto punë:

- përcjell ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa e aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të tyre me këtë ligj;
- i paralajmëron organet e komunës, organet e komunave të Qytetit të Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit për tejkalimet e kompetencave të tyre të caktuara me këtë ligj dhe me dispozitë tjetër dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e gjendjes së këtyre;
- jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të organeve të komunës, organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit në kuadrin e këtij ligji me kërkesën e tyre;
- përcjell nxjerrjen në kohë të dispozitave të komunave, dispozitave të komunave në Qytetin e Shkupit dhe dispozitave të Qytetit të Shkupit;
- i paraqet iniciativa dhe propozime komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nëse konstaton moszbatimin e këtij ligji si rezultat (pasojë) të konfliktit të interesave ndërmjet organeve të komunës, organeve të komunave në qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit.
- përcjell zbatimin e opinionit në punën e organeve të komunës, organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit, në

zbatimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, e veçanërisht nga aspekti i informimit të rregullt, në kohë, të vërtetë dhe të plotë të qytetarëve; dhe

- në kohë i informon organet e komunës, organet e komunës në Qytetin e Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për ndërmarrjen e masave gjatë mbikëqyrjes.

## **Neni 89**

(1) Nëse edhe përpos paralajmërimeve dhe masave e aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës, organet e komunave në Qytetin e Shkupit dhe organet e Qytetit të Shkupit nuk sigurojnë realizimin e punëve të cilat me këtë ligj janë përcaktuar si kompetencë e tyre dhe për realizimin e të cilave përgjegjëse është komuna, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, me fuqinë e ligjit u merret kompetenca përkatëse.

(2) Kryerja e punëve të ndërmarra nga paragrafi 1 i këtij neni e ndërmerr Ministria e Financave – Drejtoria për të hyra publike deri më një vit nga dita e marrjes së tyre.

(3) Ministria e Financave – Drejtoria për të hyra publike kryerjen e punëve me kompetencë të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nga paragrafi (2) i këtij neni, i kryen në emrin e tyre dhe në llogari të tyre.

(4) Për ndërmarrjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, informohet Ministria e Vetadministrimit Lokal.

## **PJESA E PESTË**

### **DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE**

## **Neni 90**

(1) Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të kryer do t'i kumtohet detyruesit tatimor – person juridik, përkatësisht tregtar individual nëse:

- 1) në afatin e përcaktuar nuk paraqet fletëparaqitje tatimore (nenet 29, 31 dhe 34);
- 2) pengon procedurën për arkëtimin e detyrueshëm (neni 62);
- 3) pronën nuk e ruan në gjendje të pandryshueshme (neni 69 paragrafi 5).

(2) Gjobë në shume prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik përkatësisht tregtarit individual, do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik përkatësisht tregtarit individual për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, detyruesit tatimor - person fizik do t'i kumtohet gjobë në shumë prej 200 deri më 350 euro në kundërvlerë në denarë.

## **Neni 91**

Gjobë në shumë prej 500 deri më 750 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të kryer, do t'i kumtohet personit zyrtar pranë organit shtetëror ose pranë gjykatës, nëse:

- 1) në afatin e përcaktuar nuk u dërgon komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ekzemplar nga leja me të cilën bëhet



transferi i të drejtës së pronësisë (neni 7); dhe  
2) komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit nuk u dërgon ekzemplar të vendimit për trashëgimi (neni 32).

### **Neni 92**

Gjobë në shumë prej 500 deri më 750 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të kryer do t'i kumtohet personit zyrtar në komunë, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit nëse nuk e zbaton Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së tregut të pronës së patundshme (neni 5 paragrafi (4))

### **Neni 93**

*I fshirë* 3

### **Neni 94**

(1) Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të kryer do t'i kumtohet bartësit të qarkullimit pagesor nëse vepron në kundërshtim me nenin 73 paragrafin (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur e bartësit të qarkullimit pagesor, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në bartësit të qarkullimit pagesor.

### **Neni 94-a**

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik përkatësisht tregtar individual kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje

### **Neni 94-b**

(1) Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kryetarit të komunës, nëse në afatin e përcaktuar ligjor nuk miraton aktvendim (neni 30, neni 33 paragrafi (1), neni 36 paragrafi (1) dhe neni 38 paragrafi (2)).

(2) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykatë kompetente.

### **Neni 95**

Gjobat e arkëtuara nga nenet 90, 91, 92, 93 dhe 94 të këtij ligji janë të hyra të komunës, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit në pajtim me ligjin.

## **PJESA E GJASHTË**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 96**

Me ditën e zbatimit të këtij ligji ndërpritet të vlejë Ligji për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 80/93. 3/94, 71/96, 54/2000 dhe 24/2003).

## Neni 97

Procedura për përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve mbi pronën të cilat nuk janë kryer deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji, do të kryhen sipas dispozitave të cilat kanë vlejtur deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji.

## Neni 98

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të zbatohet nga dita e konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004.

### **DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 92/2007):

#### **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa dispozita nga neni 1 i këtij ligji, do të zbatohet prej 1 janari 2008.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2012):

#### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", e do të zbatohet nga 1 janari 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

#### **Neni 12**

Procedurat e filluara të ankesës në pajtim me Ligjin për tatime mbi pronë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/2004, 92/2007, 102/2008, 35/11, 53/11, 84/12 dhe 188/13), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundohen në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Lëndët në procedurën administrative të shkallës së dytë për të cilat ka vendosur ministri i Financave apo prej tij personi i autorizuar, e për të cilat është ngritur kontest administrativ deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me ligjin me të cilin ka filluar procedura.

#### **Neni 13**

Aktet nënligjore nga neni 38-b të përcaktuara me nenin 3 të këtij ligji do të miratohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

**Neni 14**

Dispozitat nga neni 1 me të cilin ndryshohet neni 5 i këtij ligji dhe dispozitat e nenit 3 me të cilin kryhet plotësimi i neneve 38-a, 38-b, 38-v, 38-g dhe 38-d të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2016.

**Neni 15**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2016):

**Neni 29**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 30**

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimet mbi pronën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2016):

**Neni 30**

Dispozitat e neneve 10, 12, 14, 17, 23, 24 dhe 28 të këtij ligji do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).